REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosova
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance
Arkiva - Arhiva - Archive
01/02 Nr. Prot. 1243/2021
2 Data 13/08/2021
PRISHTINË/A

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova - Republic of Kosovo
### *Qeveria - Vlada – Government*
*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers*

---

**Nr. 48/2021**
**Datë: 13.08.2021**

Në zbatim të Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, në përputhje me dispozitat e nenit 8, paragrafit 1.4. të Rregullores (QRK) Nr.02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, dhe në zbatim të vendimeve të Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve nr. 40/2021 e datës 29.07.2021, nr. 43/2021 e datës 05.08.2021, dhe nr. 44/2021 e datës 06.08.2021, Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve nxjerr këtë:

**V E N D I M**
**mbi**
**themelimin e Komisionit Mbikëqyrës dhe Zbatues të Masave 1.1, 1.2 dhe 1.3 të Pakos së Ringjalljes Ekonomike**

1. Themelohet Komisioni Mbikëqyrës dhe Zbatues i masave 1.1, 1.2 dhe 1.3 i Pakos së Ringjalljes Ekonomike, me këtë përbërje:

   1.1.Sami Salihu, ATK, Kryesues;
   1.2.Agron Hamiti, ATK, Anëtar; dhe
   1.3.Vesa Janova, MFPT, Anëtare.

2. Komisioni Mbikëqyrës dhe Zbatues ka mandat që të sigurojë se institucionet përgjegjëse bëjnë zbatimin e masave nën frymën e Pakos së Ringjalljes Ekonomike dhe në përputhje me kriteret dhe kufizimet e përcaktuara me vendimet ministrore nr. 40/2021 e datës 29.07.2021, nr. 43/2021 e datës 05.08.2021, dhe nr. 44/2021 e datës 06.08.2021.

3. Në zbatim të mandatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, Komisioni Mbikëqyrës dhe Zbatues ka të drejtë të kërkojë informacione, mund të mbajë mbledhje të rregullta për qëllime koordinimi, të ofrojë këshilla dhe asistencë institucioneve përgjegjëse për zbatim të masave 1.1, 1.2. dhe 1.3, si dhe të sigurohet se masat e përmendura zbatohen në tërësi. Në veçanti, Komisioni Mbikëqyrës dhe Zbatues, obligohet që:

3.1. T'i konkretizojë dhe/ose zbërthejë kriteret dhe kufizimet e vendosura me vendimet ministrore nr. 40/2021 e datës 29.07.2021, nr. 43/2021 e datës 05.08.2021, dhe nr. 44/2021 e datës 06.08.2021, aty kur shfaqet e nevojshme;

3.2. Ta aprovojë listën finale të kualifikuarve në kuadër të masave 1.1, 1.2 dhe 1.3, të përgatitur nga institucionet përgjegjëse/implementuese dhe ta procedojë tutje tek organizata buxhetore konform vendimeve ministrore 40/2021 e datës 29.07.2021, nr. 43/2021 e datës 05.08.2021, dhe nr. 44/2021 e datës 06.08.2021.

3.3. Të kërkojë raportime dhe/ose të dhëna nga institucionet përgjegjëse për ecurinë dhe zbatimin e masave në kuadër të vendimeve ministrore 40/2021 e datës 29.07.2021, nr. 43/2021 e datës 05.08.2021, dhe nr. 44/2021 e datës 06.08.2021, në mënyrë që të përcillet ecuria e punës.

4. Gjatë kryerjes së punës së tyre, Komisioni Mbikëqyrës dhe Zbatues në veçanti do t'i zbatojë kriteret dhe/ose kufizimet e mëposhtme:

4.1. Subvencionimet në kuadër të vendimeve ministrore 40/2021 e datës 29.07.2021, nr. 43/2021 e datës 05.08.2021, dhe nr. 44/2021 e datës 06.08.2021 vlejnë dhe zbatohen vetëm për pagat primare;

4.2. Subvencionimet në kuadër të vendimeve ministrore 40/2021 e datës 29.07.2021, nr. 43/2021 e datës 05.08.2021, dhe nr. 44/2021 e datës 06.08.2021 vlejnë dhe zbatohen vetëm deri në tridhjetë (30) punonjës të një punëdhënësi/tatimpaguesi. Përjashtimisht nga kjo, subvencionimi mund të vlejë dhe zbatohet deri në pesëdhjetë (50) punonjës të një punëdhënësi/tatimpaguesi me kushtin që punonjësit punësohen në kombinim të masave 1.1., 1.2, dhe/ose 1.3 të Pakos së Ringjalljes Ekonomike;

4.3. Punëdhënësve u paguhet subvencionimi vetëm në rastin kur të punësuarit punësohen e deklarohen për qëllime tatimore në sistemin e Administratës Tatimore të Kosovës;

4.4. Gjatë gjithë kohëzgjatjes së implementimit të masave, Komisioni Mbikëqyrës dhe Zbatues mund ta bëj verifikimin e pagesës së obligimeve tatimore. Në rastet kur Komisioni Mbikëqyrës dhe Zbatues vëren se obligimet tatimore nuk përmbushen sipas legjislacionit në fuqi, Komisioni njofton organizatën buxhetore përkatëse për ndërprerje të subvencionimit.

4.5. Refuzohen aplikimet që kanë ndryshime dhe/ose korrigjime në deklarimin elektronik EDI të punëdhënësve/tatimpaguesve për efekt të përfitimit nga njëra prej masave 1.1., 1.2. ose 1.3 të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.

5. Në rast të ekzistimit të ndonjë diskpreance të kritereve dhe/ose kufizimeve në mes të këtij vendimi dhe vendimeve ministrore 40/2021 e datës 29.07.2021, nr. 43/2021 e datës 05.08.2021, dhe nr. 44/2021 e datës 06.08.2021, ky vendim do të mbizotërojë.

6. Për çështjet që nuk janë të rregulluara shprehimisht me këtë vendim, vlejnë dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

7. Komisioni Mbikëqyrës dhe Zbatues e mban të informuar Ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve apo të deleguarit e tij, rreth mbarëvajtjes së implementimit të masave, si dhe e përgatit dhe e dorëzon raportin përfundimtar lidhur me ekzekutimin e masave 1.1, 1.2 dhe 1.3 të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.

8. Komisioni Mbikëqyrës dhe Zbatues ka të drejtë të kërkojë asistencë nga zyrtarët publikë të institucioneve që zbatojnë masat 1.1, 1.2 dhe 1.3 të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, dhe jo vetëm, në çdo kohë, dhe çdo herë kur Komisioni Mbikëqyrës dhe Zbatues e vlerëson të nevojshme.

9. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Hekuran Murati**

Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve

Vendimi ju dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit;
- Zyrës së Përgjithshme të Sekretarit të MFPT-së;
- Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit;
- Departamentit Ligjor të MFPT-së; dhe
- Arkivit.